

**KONTRATE**  
**SHITJE KUOTASH**

Ne Tirane, sot me date 03 DHJETOR 2021 ne palet e meposhtme, hartojme kontraten e shitje se kuotave , si me poshte vijon :

**SHITESI :**

**Neritan DUNICARI**, i dtl. 13.02.1987, lindur ne Pogradec, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet kartes se Identitetit (ID) me numër I75213014U, me cilesine e ortakut te vetem te shoqërisë “SELECTOURS“ shpk.

**BLERËSI:**

**Jurgen Gjermiza**, e dtl. 09.01.1997, lindur ne Kukes(AL), shtetas Shqiptar, mbajtes i kartes se ID me nr. J70109046C, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar.

---

Palet e mesiperme, bazuar ne Kodin Civil te RSH, Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“ te ndryshuar me ligjin 129/2014, Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe statutit te shoqerise, hartojne kete kontrate shitje si me poshte:


Shitesi Neritan Dunicari eshte ortak i vetem i shoqerise “SLECTOURS“ shpk, e cila eshte nje shoqeri shqiptare, e regjistruar si person juridik, prane Qendres Kombetare te Biznesit me date 29/06/2021, me NIPT M11830005A, zotërues i 1 kuote me vlere te pergjithshme 100 leke, e cila përfaqëson 100% te Kapitalit te shoqerise.

**Ortaku i vetem i Shoqerise, me vendimin nr. 2 date 03 DHJETOR 2021 ka vendosur :**

1. Transferimin nepermjet shitjes se 1 kuote te zoteruar nga ortakut i vetem z. Neritan Dunicari ne shoqerine « SELECTOURS », me vlere 35 leke, e cila perfaqeson 35 % te kapitalit te shoqerise, ne favor te ortakut te ri Jurgen Gjermiza, e dtl. 09/01/1997 , lindur ne Kukes (AL), shtetas shqiptar, mbajtes e ID me Nr. J70109046C.

**Objekti i kontrates**

*Referuar Kodit Civil te RSH, statutit te shoqerise, Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“ te ndryshuar me ligjin 129/2014, Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Shitesi Neritan DUNICARI, transferon nepermjet shitjes 1 kuote te zoteruar prej tij ne shoqerine “SELECTOURS” me vlere te pergjithshme 35 leke, e cila perfaqeson 35 % te kapitalit te shoqerise, ne favor te ortakut te ri Jurgen GJERMIZA.*



### Çmimi i shitjes

Çmimi i shitjes se 1 kuote te zoteruara nga ortaku Neritan DUNICARI dhe qe po transferohet nepermjet kesaj kontrate ne favor te ortakes se re Jurgen Gjermiza eshte 35 leke.

Bleresi deklaroi se ka paguar plotesisht çmimin e shitjes dhe shitesi deklaroi se e ka marre çmimin e plote te shitjes dhe nuk ka asnje pretendim.

### Garancite

Shitesi deklaroi dhe garantoi bleresin se eshte i vetmi titullar i ligjshem i kuotes qe po transferon nepermjet kesaj kontrate dhe se ajo eshte e lire nga çdo barre apo pretendim tjetër ligjor.

### Heqje dore nga te drejtat

Shitesi deklaroi nen pergjegjesine e tij personale, se nuk ka me asnjë pretendim dhe heq dore nga te gjitha te drejtat qe i takojne mbi zoterimin e kesaj kuote qe po transferon nepermjet kesaj kontrate.

### Te ndryshme

Pas transferimit shoqeria mbetet me dy ortakë Neritan Dunicari zoterues i 1 kuote me vlere 65 leke e cila perfaqeson 65% te kapitalit dhe Jurgen Gjermiza zoterues i 1 kuote me vlere 35 leke e cila perfaqeson 35% te kapitalit.

### Pjesët perberese te kontratës

Pjesët përbërëse të kësaj kontrate janë: ekstrakti i shoqërisë, vendimi i Ortakut te vetem të Shoqërisë "SLECT TOURS" shpk, fotokopjet e dokumenteve identifikuese.

Kjo kontratë u hartua në katër ekzemplarë me vlere të njëjta juridike, në gjuhën shqipe

SHITESI

Neritan DUNICARI

*Neritan Dunicari*



BLERESI

Jurgen GJERMIZA

*Jurgen Gjermiza*

